

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për president, reagon LVV - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/bekim-sejdiu-terhiqet-nga-kandidatura-per-president-reagon-lvv/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 20:32:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 20:25:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5e80ebd58b7f4b1ad4f334ab0afd39d18d528f6b9f2d44fdc1710baab396be24
TEKSTI	226a26bfbeef3c8d6a7c56e0d3ac40183376ae9295016d88fbaafde9f9384e98
PAMJA	fee4c5256274b63c736313783384c50ae595958d0e00d3c221d09cccf43a54e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	626cb4878e1b98575462b026c8d3eb7bf19c21f58baa3c4d02b0c2734aca7a80
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	14f4bd53e2e66d8385ba6de2378a49e0445f54add9285267e471b01ae86271f6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/626cb4878e1b98575462b026c8d3eb7bf19c21f58baa3c4d02b0c2734aca7a80>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Bekim Sejdiu Inteligjenca Artificiale Bashkimi Evropian Donald Trump Erion Veliaj

KOSOVË

Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për president, reagon LVV

14 Shtator 2026 | 22:25

Lëvizja Vetëvendosja ka reaguar pas vendimit të kandidatit për deputet, Bekim Sejdiu për t'u tërhequr nga kandidatura për president të Kosovës.

Përmes një deklaratë për mediat 'Lëvizja VETËVENDOSJE! shpreh keqardhjen për tërheqjen e profesorit Bekim Sejdiu nga kandidatura për President të Republikës së Kosovës'.

'Bekim Sejdiu ishte kandidat i përbashkët, i dalë nga marrëveshja ndërmjet Lëvizjes VETËVENDOSJE! dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës. Marrëveshja u arrit pas bisedimeve politike dhe me vullnetin për t'i dhënë vendit një zgjidhje. Kandidatura e tij krijoi mundësinë që zgjedhja e Presidentit të përmbyllej në Kuvend dhe Kosova të mos hynte sërish në një periudhë pasigurie institucionale.

Lëvizja VETËVENDOSJE! i qëndroi kësaj marrëveshjeje dhe kandidatit të përbashkët deri në fund.

Fatkeqësisht, pas arritjes së marrëveshjes, një pjesë e deputetëve të LDK-së doli kundër kandidaturës së miratuar edhe nga partia e tyre. Ndërsa PDK-ja dhe Aleanca u deklaruan se nuk do të merrnin pjesë në procesin e zgjedhjes së Presidentit.

Kështu u krijuan rrethanat që e pamundësuan zgjedhjen e Presidentit në Kuvend.

Në këto rrethana erdhi edhe vendimi i profesorit Sejdiu për t'u tërhequr.

Për muaj me radhë u kërkuua dialog, kompromis dhe marrëveshje. Dialogu u zhvillua, kompromisi u bë, marrëveshja u arrit dhe kandidati i përbashkët u gjet. Kur erdhi koha që marrëveshja të merrte votën e Kuvendit, nisi pengimi dhe goditja e saj.

Kuvendi është vendi ku dallimet politike shprehen me votë. Mund të votosh për, mund të votosh kundër. Por kur mospjesëmarrja përdoret për ta pamundësuar votimin, atëherë nuk kemi më dallim politik rreth një kandidati, por pengim të vetë procesit kushtetues dhe dërgimin e vendit në zgjedhje të përsëritura.

E falënderojmë profesor Bekim Sejdiun për gatishmërinë për t'i shërbyer Republikës dhe për dinjitetin e treguar gjatë këtij procesi.

Kosova e pati marrëveshjen dhe kandidatin e përbashkët. E pati mundësinë që çështja e Presidentit të zgjidhej në Kuvend. Por u bllokua, sërish, thuhet në deklaratën e LVV.

LAJMI I FUNDIT

22:17 "Erion Veliaj mund të lirohet nesër", analisti tregon si do të procedojë Gjykata e Lartë me kryebashkiakun

22:16 Britani, burri rrëfen se e drogoi dhe përdhunoi gruan e tij për dy dekada

22:04 Ish-agjenti maroken ofroi informacione për spiunazhin e Marokut në këmbim të mbrojtjes nga ekstradimi në Spanjë

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

21:48 "Nëse Veliaj del nga burgju, do të jetë rrezik për Ramën", Zekthi: Do të rikthehet më i fortë politikisht

21:44 Afrika e Jugut, 21 të vdekur në një sulm me makinë-bombë

21:32 Anthropic propozon metodën e mbylljes së plotë të inteligjencës artificiale: Mund të bëhet i detyrueshëm me ligj

TESTIM

Në një postim në Facebook, Sejdiu ka thënë se duke u marrë parasysh rrethanat, të karakterizuara nga mungesa e mbështetjes së nevojshme parlamentare për t’u zgjedhur e po ashtu nga devijimi i tërë procesit, ka vendosur të tërhiqet dhe se për këtë ka njoftuar edhe përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ata të Lëvizjes Vetëvendosje.

Sejdiu ishte prezantuar si kandidat konsensual për president dy javë më parë, pas marrëveshjes së dakorduar mes VV-së dhe LDK-së.

Shiko në:

| LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | RAJONI
Lumir Abdixhiku: Bekim Sejdiu tregoi dinjitet
Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka reaguar pas tërheqjes së Bekim Sejdiut nga kandidatura për President të Kosovës. Abdixhiku e ka vlerësuar...
20:00 | 14/09/2026

KOSOVË | LAJMI KRYESOR | RAJONI
Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për President
Bekim Sejdiu është tërhequr nga kandidatura për president të Republikës së Kosovës. Lajmin e ka bërë të ditur vetë Sejdiu përmes një postimi në Facebook,...
18:54 | 14/09/2026

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT | RAJONI
PDK konteston qeverinë “Kurti 4” në Kushtetuese, kabineti i ri nis punën
Një orë para se Qeveria e katërt e Albin Kurtit të niste punën, zgjedhja e saj është kontestuar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Ndërkohë, kabineti...
17:00 | 14/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontaktoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026